

URDHËR
Nr. 541, datë 24.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “F”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë”; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të neneve 28, 29 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Ministrinë e Mbrojtjes, znj. Florenca Korbi, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, e cila sipas urdhrit nr. 526, datë 19.3.2026, ushtron funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes.
 2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga znj. Florenca Korbi duke filluar nga data 24.3.2026.
 3. Këto kompetenca nuk mund të nëndelegohen.
 4. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegates, apo të deleguar.
 5. Kompetencat delegohen për të gjitha procedurat e prokurimit, përjashtuar atyre të deleguara me urdhrin nr. 1498, datë 4.9.2024.
 6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në detyrë dhe çdo strukturë përgjegjëse për procedurat e prokurimit.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Ermal Nufi